



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7765

Data: 13.09.2023

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR PËR GRATË PËR DRAFT BUXHETIN
PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2025-2026**

Procesverbali nga Dëgjimi i parë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026, të mbajtur me datën **14.08.2023**, duke filluar nga ora **11:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 17 pjesëmarrës, prej tyre 13 gra dhe 4 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, si dhe drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2024, si dhe parashikimi për vitet 2025-2026, ku për rend të punës, ishte:

- 1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**
- 2. Diskutimi**

Mehmet Ballazhi thekson: Ky është dëgjimi i dytë buxhetor që po e realizojmë në kuadër të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026. Pjesëmarrja juaj do të thotë se ju mund të jeni pjesëmarrës për me i orientu projektet. Për prezentim më të hollësisht, do ta merr fjalën Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

- 1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur diskutime me asamblenë

komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2024 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,583,941.00 €), granti specifik për arsim (1,089,623.00€), granti specifik për shëndetësi (401,388.00€) dhe të hyrat vetanake komunale (274.736.00 €). Pra, buxheti total për vitin 2024 do të jetë 3,349,278.00 €. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2024, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore, përveç tek të hyrat vetanake komunale ku do të ketë rënie prej 51%. Mandej vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

2. Diskutimi

Mehmet Ballazhi: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit.

Resmije Ballazhi: Problem për gratë vazhdon me mbetë çështja e punësimit, ku kemi shembull fabrikën e tekstilit në Kaçanik ku disa gra nga Hani i Elezit punojnë aty dhe e kanë të sigurm edhe transportin.

Majlinda Kaloshi: Ne e kemi mbajtur një takim me Zyrën e Punësimit dhe pronarin e fabrikës së tekstilit Inex, të cilët na kanë siguru që mundësohet edhe transporti për punëtoret dhe na ka kërku me e pa se sa interesim ka nga gratë e Hanit të Elezit, megjithatë kemi me mbajtur edhe një takim informues në lidhje me këtë çështje.

Hyrijete Isufi: Problem vazhdon me qenë mungesa e ujit. Si dhe te çështja e parkut "Isa Berisha" është një kryevepër, por shoh që për nga mirëmbajtja nuk është shumë në rregull, përveç lojërave që po prishen, po shihet nevojë e ujitjes së parkut, dhe kisha sugjeru që me e angazhu dikë për kontroll dhe pse jo me fillu me i dënu. Poashtu bunkerat te parku, sa do të ishte mundësia që atje të hapen së paku ndonjë kafene për gratë, ku edhe do të mund të punësohej ndonjë grua.

Mehmet Ballazhi: Faza testuese veçse ka mbaru ku uji del i pastër, por problemin e kemi me e bo një lloj analize se sa kapacitet ka uji për sasinë që i nevojitet një familje. Por, kjo mangësi ndodh sepse po keqpërdoret uji dhe krijohet disbalancë, prandaj me urgjencë e kemi kontakti Bifurkacionin që ta merr në menaxhim, pra vendosjen e njehsorëve për me fillu me pagesë, dhe me këtë rast fillon evidentimi i keqpërdorimeve, dhe sipas matjeve tona del që janë 350 litra në ditë për 1 person, dhe nga ky burim i ujit furnizohen 5000 banorë, pra del ujë i mjaftueshëm nga

burimi, por ka mungesë deri te konsumatorët dhe e gjitha vie si pasojë e keqpërdorimeve të shumta, dhe zgjidhja e vetme osht marrja në menaxhim nga Bifurkacioni. Kurse te pjesa e parkut, para së gjithash nevojitet vetëdijësim, por kam thënë edhe herë të tjera që nëse edhe 100 herë i prishin , edhe 100 herë kemi me i rregullu, deri sa të arrihet vetëdijësim, e më vonë mundet me u parapa edhe dënimet.

Majlinda Kaloshi: Ideja e bunkerave ka qenë edhe kjo që me u rujt një pjesë e historisë, përveç tyre gjithashtu edhe pjesa e rrethojave si këmbëngulje nga Kryetari, ku kemi mendu si alternativë edhe një muze e qytetit, por jemi të hapur me bashkëpunu me bizneset që janë të gatshme me investu aty, gjithashtu po i shohim mundësitë edhe për vendosjen e kioskave për bizneset që nuk kanë mundësi me investu në bunkerë, ku kemi parapa edhe në Rregulloren për taksa komunale për vitin 2024, që OJQ me i liru nga taksat për shfrytëzimin e hapësirave publike, mjafton të kenë lejen nga Komuna.

Ibadete Kalisi: Nji kërkesë për te ura (mbikalimi te hekurudha) për me e bo një mbikalim për personat me aftësi të kufizume, si dhe për fëmijët e vegjël që janë me karroca, të cilët duan me e dal te parku “Isa Berisha” nga pjesa e poshtme e hekurudhës.


Mehmet Ballazhi: Në një takim që kemi pas me Infracosin, më kanë premtu që kanë me bo rampa që do të jenë me standarde për personat me karrocë, por nuk di saktë se kur mund ta realizojnë edhe pse afati për me i përfundu punimet në hekurudhë është shtatori i vitit të ardhshëm. Ndërsa nga ana e Komunës, ne kemi bo një projekt për një mbikalim te çerdhja, por që për realizimin e tij nevojitet buxhet nga qeveria, sepse kushton diku 1,145,000 € dhe komuna nuk ka kapacitet buxhetor për me e financu, megjithatë jemi në diskutime me Ministrinë e Infrastrukturës, jemi të fokusuar me e çu përpara si projekt dhe kemi shpresë se mund të gjejmë përkrahjen nga Ministria.

Lindita Ballazhi: Ne i kemi shënuar të gjitha kërkesat e juaja dhe të gjitha do të shqyrtohen. Çfarëdo kërkesë që keni, jo vetëm nëpër dëgjime, por çdo herë dyert tona janë të hapura në çdo kohë.

Mehmet Ballazhi: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor të dedikuar për gratë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:52.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Lista e pjesëmarrësve – Takimi i dytë me qytetarë lidhur me planifikimin e
buxhetit për vitin 2024

Data: 14.08.2023

Ora: 15:00

Vendi: Salla e takimeve – Komuna Hani I Elezit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni/Vendi	Telefoni	Nënshkrimi
1	Iskender Kuka	Asambleiste		
2	Xhemile Ballazhi	Amvisë		Xh.Ballazhi
3	Reemije Ballazhi	PUNTORE		RE
4	Sara Berisha	Asisteny KK		Sara
5	Natyra Kalisi			Natyra
6	MAJLINDA KALISI			M.Kalisi
7	XHEMILE CURRI			X.Curri
8	Hyrrije Jusufi	kehillorë në ansamble		H.Jusufi
9	Safije Ahmedi	puntore i P.		S.Ahmedi
10	Medade Ballazhi	Drejtoresh i.P		M.Ballazhi
11	LIRIDONA BALLAZHI	K.H.E		L.Ballazhi
12	LINDITA BALLAZHI	K.H.E		L.Ballazhi
13	Dufeta Daci	K.H.E		D.Daci
14	Lindon Bushi	K.H.E		L.Bushi
15	ARSIM DERDANI	KHE		A.Derdani
16	Hisni Luni	KHE		H.Luni
17	MEHMET BALLAZHI	KRYETAR		M.Ballazhi
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				